Sa i përket sektorit të Pemëtarisë në komunën tonë kemi kultivimin e këtyre llojeve të pemëve që janë të paraqitura në tabelën si më poshtë:

| Nr. | Fondi i Perimeve; |
|------------|--------------------------|
| 1 | Mollë; |
| 2 | Dardhë; |
| 3 | Kumbull; |
| 4 | Pjeshkë; |
| 5 | Qershi; |
| 6 | Vishnje; |
| 7 | Kajsi; |
| 8 | Ftua; |
| 9 | Mushmollë; |
| 10 | Arrë; |

| | |
|-----------|-------------------|
| 11 | Lajthi; |
| 12 | Mjedra; |
| 13 | Aronija; |
| 14 | Dredhëza; |
| 15 | Vreshtari; |

- Prej këtyre llojeve të pemëve, më së shumti kultivohen molla, kumbulla dhe arra. Në sektorin e pemëve kemi rritje të sipërfaqeve të mbjella me arra dhe lajthi, këtu kanë ndikuar aplikimi për pagesa – direkte për subvencione dhe grante nga Ministria e bujqësisë. Pastaj kemi rritje të sipërfaqeve edhe me bimë mjekuese aromatike.

- **Zhvillimi rural;**

- Zhvillimi rural është një proces në të cilin popullata rurale (individët, ekonomitë familjare dhe komuniteti) i bashkojnë resurset e tyre dhe i përmirësojnë kushtet e tyre të jetës dhe punës, përmes zhvillimit të aftësive të tyre, rritjes së aftësive të tyre analitike dhe kërkuese dhe duke formuar organizatat e komunitetit, që ndikojnë në përmirësimin e të ardhurave të tyre, përmirësimin e shëndetit, edukimit, infrastrukturës dhe shërbimeve sociale.

Së fundi, banorëve të zonave rurale u jepet mundësia që të kontribuojnë për lirinë civile, të menaxhojnë vet zhvillimin e tyre me marrëdhënie të balancuara gjinore dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore lokale.

Qasja bashkëkohore lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm rural nënkupton një qasje komplekse e cila përfshinë: bujqësinë, resurset nacionale dhe menaxhimin e tyre, transportin rural, ujin dhe higjienën, telekomunikimet, edukimin, shëndetësinë, shërbimet sociale.

| | | | |
|--|-------------------------------------|--|-----------------|
| | Emërtimi i temave trajnuese; | Koha e mbajtjes së trajnimeve / sipas javëve; | Zyrtari; |
|--|-------------------------------------|--|-----------------|

| Nr. | | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qersho | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | |
|-----|---|-------|--------|------|-------|-----|--------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|---------------------------------|
| 1 | Kultivimi i dredhëzës për prodhim, (pastrimi i sythave, plehërimi, mbrojtja); | | III | | | | | | | | | | | Bektesh Dërmaku; |
| 2 | Seleksionimi i viçave femra për mbarështim (vlerësimi i eksterierit); | | | I | | | | | | | | | | |
| 3 | Krasitja dimërore e pemëve (molla, kumbulla, dardha etj.); | | | II | | | | | | | | | | |
| 4 | Krasitja e gjelbërt te pemët; | | | | | | I | | | | | | | |
| 5 | Ngritja e stallave me infrastrukturë përcjellëse (lopëve qumështore dhe viçave për majmëri, sistemet e mbarështimit); | | | | | I | | | | | | | | |
| 6 | Të ushqyerit e perimeve në serrë me plehra kristalore (starter 20:20:20, finisher); | | | | I | | | | | | | | | |
| 7 | Silazhimi i misrit; | | | | | | | | | I | | | | |
| 8 | Të ushqyerit e kafshëve të imta; | | | | | | | | | | | I | | |
| 9 | Diversifikimi i fermës; | | | | | | | | | | II | | | |
| 10 | Mbajtja e shënimeve në fermë; | | | | | | | | | | | | I | |
| 11 | Përgatitja e leheve dhe përzgjedhja e farërave për mbjellje; | III | | | | | | | | | | | | Almedina Kryeziu Spahiu; |
| 12 | Faza e ndërrimit të fidanëve nga modulet në serra; | | | III | | | | | | | | | | |
| 13 | Mbrojtja e kulturave lavërtare; | | | | II | | | | | | | | | |
| 14 | Tenja (Tuta Absolute) te domatja; | | | | | II | | | | | | | | |
| 15 | Mbrojtja e pemëve dhe perimeve pas vjeljes; | | | | | | | | | IV | | | | |
| 16 | Masat të cilat merën pas pastrimit te serës – përgatitja e tokës; | | | | | | | | | | | IV | | |
| 17 | Përmirësimi i Ushqimit të Kafshëve; | | II | | | | | | | | | | | Qëndrim Dërmaku; |
| 18 | Masat profilaktike për parandalimin e sëmundjeve; | | | | | | | | | III | | | | |
| 19 | Menaxhimi i Kullotave; | | | | III | | | | | | | | | |
| 20 | Ri projektimi i Fermave; | | | | | | | | | | | IV | | |
| 21 | Rritja e efikasitetit të mjeljes; | | | | | | II | | | | | | | |
| 23 | Përgatitje për stinën e nxehtë; | | | | | | | I | | | | | | |
| 25 | Përzgjedhja e varieteteve të farërave të domates dhe specave në serrë; | II | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|--|--|----|----|----|---|--|--|--|--|--|--|--|--|-------------------|
| 26 | Plehërimi dhe ri plehërimi i kulturës së grurit; | | IV | | | | | | | | | | | | Kaltrina Kadriji; |
| 27 | Përgatitja e ngastrave për mbjelljen e kulturës së misrit; | | | IV | | | | | | | | | | | |
| 28 | Ujitja e perimeve në sera dhe përdorimi i plehrave kristalorë; | | | | IV | | | | | | | | | | |
| 29 | Faza e largimit të thithakëve tek domatja dhe speci dhe rëndësia e tyre; | | | | | I | | | | | | | | | |

Zhvillimi rural në Komunën e Kamenicës përballet me shumë probleme specifike; standardi i ulët i popullsisë rurale, shkalla e ulët e arsimimit në zonat rurale, infrastruktura e dobët, niveli i ulët i prodhimit bujqësor dhe rritja e ngadalshme ekonomike me një bazë të gjerë.

- Përmirësimi i përgjithshëm i kushteve të jetesës mund të arrihet vetëm me një infrastrukturë rurale të zhvilluar, por jo vetëm kaq, infrastruktura rurale është edhe parakusht esencial për rritjen e prodhimtarisë bujqësore, rritjes së aftësive konkurruese, si dhe rritjen e profitabilitetit dhe në përgjithësi krijimin më të madh të hyrave, që ndikojnë në rritjen e standardit jetësor.

Duke e zhvilluar infrastrukturën në Komunë, përmirësimin e kushteve të jetesës në përgjithësi do të pengojë edhe fenomeni i migrimit të popullatës nga zonat rurale drejt atyre urbane.

- Në tabelën e më poshtme janë të paraqitura temat e caktuara për trajnime të planifikuara për mbajtjen e tyre sipas javëve dhe muajve nga zyrtarët e drejtorisë së bujqësisë:

| Nr. | Emërtimi i projekteve; | Shuma e projekteve në/ €. | | Koha e realizimit projektit; |
|--------------------|---|---------------------------|----------------------|--------------------------------|
| | | Subvencione; | Mallra dhe Shërbime; | |
| 1 | Subvencionimi i qumështit për litër; | 100,000.00 €. | | Shkurt- Mars/ Korrik -Gusht |
| 2 | Furnizim i fermerëve me farë gruri dhe pleh artificial; | 15,000.00 €. | | Shtator -Tetor |
| 3 | Bletaria; | 5,000.00 €. | | Mars- prill |
| 4 | Mekanizëm bujqësor; | 30,000.00 €. | | Shtator- Tetor |
| 5 | Hortikulturë - Pyllëzim; | 10,000.00 €. | | Gusht –Shtator |
| 6 | Trajtimi i qenëve endacak; | | 25,000.00 €. | Kontratë kornizë |
| Gjithsejtë: | | 160,000.00 €. | 25,000.00 €. | |

- *Planifikimi i aktiviteteve që do të realizohen nga zyrtarët e drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2026.*
 - *Aktivitetet do të realizohen nga zyrtarët e DBPZHR të cilat parashihen konform detyrave të punës që kanë:*
 - *Që nga fillimi i muajit Janar, DBPZHR i fillon punët për kryerjen e tyre sipas planifikimit.*
- Daljet në teren, vizita fermerëve dhe mbajtja e trajnimeve brenda vitit 2026;
- Informatë për MBPZHR rreth planifikimit dhe Realizimit të mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore për vitin 2026;

- Mbajtja e temave trajnuese për fazën pranverore;
- Mbajtja e sesionit informues për fermerët aplikues në subvencione e MBPZHR.;
- Fazën e aplikimit për Pagesa direke – Subvencione nga MBPZHR. – AZHB. - ja,;
- Faza e aplikimit të fermerëve për Grante në kuadër të MBPZHR.;
- Takim me fermerët lider për parashtrimin e temave që do të organizohen nga departamenti i këshillimeve shërbimeve këshilluese;
- Organizimi i vizitës të fermerëve lider me fermer lider të komunave tjera për shkëmbim të përvojave të mira në bujqësi;
- Monitorimi i fermerëve lider dhe të arriturat e vitit në të gjithë sektorët e bujqësisë;
- Pastaj mbajtja e temave trajnuese për sektor të ndryshëm nga zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë;
- Organizimin e mbajtjes së temave trajnues – këshilluese nga këshilltarët e caktuar nga MBPZHR.;
- Përpilimi i raporteve mujore të punës për departamentin e shërbimeve këshilluese në MBPZHR.;
- Bashkëpunimi me organizatat e huaja ,(ndërkombëtare);
- Vlerësimet e dëmeve në bujqësi nga fatkeqësitë natyrore;
- Vlerësimi i dëmeve në bujqësi në prona komunale;

- Hapja zyrtare e fushatës së korrje –shirjeve;
- Informata e parë pas fillimit të korrje-shirjeve, Informata e dytë dhe informata përfundimtare e korrje shirjeve për Mbpzhr. dhe Komunën (aktivitetet);
- Përgatitja e projekt propozimeve, Inicimi i projekteve nga buxheti i Komunës dhe Drejtorisë, si subvencionimi i disa lëmive të bujqësisë psh: në Blegtori, Bletari, Lavërtari, Perimekulturë, Pemëtari etj.;
- Fillimin, përcjelljen dhe përfundimin e projekteve nga DBPZHR.;
- Ruajtja e dokumentacionit të projekteve në arkiv;
- Mbledhja, sigurimi, mbajtja e statistikave bujqësore mbi sipërfaqet bujqësore, prodhimtarinë bujqësore, fondin blegtoral, mekanizmin bujqësor, kapacitetet përpunuese të prodhimeve bujqësore si dhe bën analiza në përpunimin e të dhënave në baza vjetore etj.;
- Regjistrimi i fermerëve të rinjë në programin e eFR-ës të MBPZHR.;
- Propozim ndryshim i Rregullores për kushtet kriteret në ndarjen e subvencioneve komunale për bujqësi;
- Menaxhimi kontratës të rregullta dhe kontratave kornizë;
- Menaxhimi dhe trajtimi me qenët endacak;
- Menaxhimi me tokat bujqësore (rreth ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore);
- Bashkëpunimi me Agjencionin e pylltarisë rreth pyllëzimit të tokave pyjore;

- Menaxhimi me vend gjahishten;
- Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi: Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural, ligji për tokat bujqësore, Ligji për blegtori, Ligji për veterinari, Ligji për shërbime këshilluese, Ligji për mbrojtjen e bimëve, Ligji për pesticidet, Ligji për farërat;
- Pajisja me vërtetime për bletarët;
- Pajisja me leje ujore;
- Formulimi i të gjitha akteve administrative të DBPZHR.;
- Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacioneve të rëndësishme;
- Inicimi i ndryshimeve të rregulloreve aplikative me ligjet në fuqi;
- Dhënia e ndihmës juridike stafit të bujqësisë për interpretim dhe zbatim ligjeve dhe akteve tjera në fuqi;
- Ushtrimi i ankesave të DBPZHR.;
- Procedimi-cedimi i lëndëve për procedurë të mëtutjeshme.

❖ Aktivitetet dhe afatet kohore të implementimit të punëve;

1. Bektesh Dërmaku – Zyrtar për Zhvillim Rural;

| Nr. | Aktivitetet; | Afati kohor; | Përgjegjësi; |
|------------|---|---------------------|---------------------|
| 1 | Këshilla profesionale fermerëve varësisht nga nevoja e fermerit; | Janar Dhjetor | MBPZHR. |
| 2 | Propozoj masa për mbështetje e fermerëve varësisht nga nevojat e tyre në DBPZHR dhe MBPZHR.; | Janar Dhjetor | Drejtori |
| 3 | Faza për aplikimin për Qumësht /litër, Pagesat – direke; | Janar – shkurt; | MBPZHR. |
| 4 | Faza e aplikimin për subvencionim të Qumështit / lit. 0.05 €. /lit.; | Janar – shkurt; | Komuna. |
| 5 | Faza për aplikimin për Pagesa – direke - Subvencionet për gjitha kulturat bujqësore – vazhdimi i aplikimit; | Mars; | MBPZHR. |
| 6 | Faza për aplikimin për Pagesa – direke - Subvencionet për gjitha kulturat bujqësore – vazhdimi i aplikimit; | Prill; | MBPZHR. |
| 7 | Përcjell kulturat e ndryshme rreth rendimentit- cilësisë dhe jep informata te reja bujqësore – fermerëve; | Janar dhjetor | Drejtori |
| 8 | Përgatit, implementon dhe monitoron projekte që planifikohen rreth bujqësisë dhe zhvillimit rural; | Janar Dhjetor | Drejtori |
| 9 | Propozoj politika zhvillimore sektoriale në bujqësi; | Mars | MBPZHR. |
| 10 | Vlerësimi i dëmeve në bujqësi nga fatkeqësitë natyrore dhe në prona komunale; | Prill | Drejtori |
| 11 | Menaxhimi i kontratave të ndryshme; | Maj | Drejtori |
| 12 | Hapja zyrtare e fushatës së korrje –shirjeve; | Qershor –Korrik; | Drejtori |
| 13 | Faza për aplikimin për Qumësht /litër, Pagesat – direke; | Gusht; | MBPZHR. |
| 14 | Aplikimi për subvencionim të Qumështit / litër, 0.05 €. / lit.; | Gusht; | Komuna. |
| 15 | Pjesëmarrje në komisione të caktuara me vendime për projekte të ndryshme; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |

| | | | |
|----|--|-------------------|----------|
| 16 | Përgatitja e raporteve mujore për MBPZHR. (Shërbimet këshillimore – AZHB.); | Janar/ Dhjetor | MBPZHR. |
| 17 | Pjesëmarrja në super kontrolle me MBPZHR. (Sektori i kontrollave – AZHB.); | Janar/ Dhjetor | MBPZHR. |
| 18 | Përgatitja e raportit vjetor te punës / 2026; | Janar /Dhjetor | Drejtori |

Tabela 1.

| Nr. | Planifikimi i temave trajnuese për vitin 2026. (DBPZHR.) | Afati kohor; | Përgjegjësi ; |
|-----|---|--------------|---------------|
| 1 | Kultivimi i dredhëzës për prodhim, (pastrimi i sythave, plehërimi, mbrojtja); | Shkurt | Drejtori |
| 2 | Seleksionimi i viçave femra për mbarështim (vlerësimi i eksterierit); | Mars | Drejtori |
| 3 | Krasitja dimërore e pemëve (molla, kumbulla, dardha etj.); | Mars | Drejtori |
| 4 | Të ushqyerit e perimeve në serrë me plehra kristalore (starter 20:20:20, finisher); | Prill | Drejtori |
| 5 | Ngritja e stallave me infrastrukturë përcjellëse (lopëve qumështore dhe viçave për majmëri, sistemet e mbarështimit); | Maj | Drejtori |
| 6 | Krasitja e gjelbër te pemët; | Qershor | Drejtori |
| 7 | Silazhimi i misrit; | Shtator | Drejtori |
| 8 | Diversifikimi i fermës; | Tetor | Drejtori |
| 9 | Të ushqyerit e kafshëve të imëta; | Nëntor | Drejtori |
| 10 | Mbajtja e shënimeve në fermë; | Dhjetor | Drejtori |

Tabela 2.

| Nr. | Planifikimi i temave trajnuese me kërkesa të fermerëve Lider të organizuara nga MBPZHR. – DBPZHR. për vitin 2026. | Afati kohor; | Përgjegjësi; |
|------------|--|---------------------|---------------------|
| 1 | Përgatitja e vendit për mbjelljen e fidanëve të perimeve në serra (nga modulet); | Shkurt; | MBPZHR. |
| 2 | Krasitja pranverore e pemëve – ARRA; | Mars; | MBPZHR. |
| 3 | Sëmundjet e bletëve (Pesta Amerikane); | Mars | MBPZHR. |
| 4 | Masat për përgatitjen e gjedhit për kullosë; | Prill; | MBPZHR. |
| 5 | Përdorimi i herbicideve te kultura e grurit; | Prill; | MBPZHR. |
| 6 | Të ushqyerit e vëçave për trashje (balancimi i ushqimeve të koncentruar); | Qershor; | MBPZHR. |
| 7 | Përgatitja e tokës për mbjellje dhe përzgjedhja e farës për mbjellje ; | Shtator; | MBPZHR. |
| 8 | Përgatitja e bletëve për dimërim; | Shtator; | MBPZHR. |
| 9 | Vjelja dhe përpunimi i pemëve; | Tetor; | MBPZHR. |
| 10 | Masat të cilat merren pas pastrimit te serës – përgatitja e tokës (dezinfektimi); | Nëntor | MBPZHR. |

1. Almedina Kryeziu Spahiu – Zyrtare për Bujqësi;

| Nr. | Aktivitetet; | Afati kohor; | Përgjegjësi ; |
|------------|---|---------------------|----------------------|
| 1. | Faza për aplikimin për Pagesat – DirekTe, Subvencione për 6 M – 2 / 2025: | Janar – shkurt; | MBPZHR. |
| 2. | Faza e aplikimit për subvencionim të Qumështit /lit. 0.05 €/lit.- 6 M- /2025; | Janar – shkurt; | Komuna |
| 3. | Tema trajnuese: Përgatitja e leheve dhe përzgjedhja e farërave për mbjellje; | Janar | Drejtori |
| 4. | Tema trajnuese: Faza e ndërrimit të fidanëve nga modulet në serra; | Mars | Drejtori |
| 5. | Aplikimi i fermerëve për pagesa direkte/subvencione; | Mars | MBPZHR |
| 6. | Tema trajnuese: Mbrojtja e kulturave lavërtare; | Prill | Drejtori |
| 7. | Tema trajnuese: Tenja (Tuta Absolute) te domatja; | Maj | Drejtori |

| | | | |
|------------|--|-----------------|----------|
| 8. | Hapja zyrtare e fushatës së korrje –shirjeve; | Qershor | Drejtori |
| 9. | Faza për aplikimin për Pagesat – Direkte, Subvencione për 6 M – 1 / 2026; | Janar – shkurt; | MBPZHR. |
| 10. | Faza e aplikimit për subvencionim të Qumështit / lit. 0.05 €/lit.- 6M -1 /2026; | Janar – shkurt; | Komuna. |
| 11. | Tema trajnuese: mbrojtja e pemëve dhe perimeve pas vjeljes; | Shtator | Drejtori |
| 12. | Pjesëmarrje në komisione të caktuara me vendime për projekte të ndryshme ; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 13. | Menaxhimi i kontratave të ndryshme; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 14. | Tema Trajnuese: Masat të cilat merren pas pastrimit te serës – përgatitja e tokës; | Nëntor | Drejtori |
| 15. | Përgatitja e raportit vjetor te punës 2026; | Dhjetor | Drejtori |

1. Qëndrim Dërmaku– Zyrtar për Veterinari;

| Nr. | Aktivitetet; | Afati kohor; | Përgjegjësi; |
|-----|---|--------------|--------------|
| 1. | Aplikimi për subvencionim të qumështit, 6M-2/2025 | Janar | MBPZHR. |
| 2 | Aplikimi për subvencionim të qumështit për litër 0.05€/lit. 6M-2/2025; | Janar | Komuna |
| 3 | Tema trajnuese: Përmirësimi i Ushqimit të Kafshëve; - Testimi i përzierjeve të reja ushqimore për rritjen e prodhimit të qumështit ose mishit; - Përdorimi i bimëve lokale si burim ushqimor me kosto të ulët; | Shkurt | Drejtori |
| 4 | Aplikimi i fermerëve për pagesa direkte/subvencione | Mars | MBPZHR |
| 5 | Tema trajnuese: Menaxhimi i Kullotave; - Rrotullimi i kullotave për të shmangur degradimin e tokës dhe për të rritur produktivitetin; - Hedhja e farave të bimëve blegtorale në kullota për diversitet ushqimor; | Prill | Drejtori |
| 6 | Hapja zyrtare e fushatës së korrje –shirjeve | Qershor | Drejtori |
| 7 | Tema trajnuese: Rritja e Efikasitetit të Mjeljes; - Trajnim për teknikat moderne të mjeljes për të rritur cilësinë dhe sasinë e qumështit; - Përdorimi i pajisjeve të thjeshta higjienike (filtra, sterilizim) për të reduktuar kontaminimin; | Qershor | Drejtori |
| 8 | Tema trajnuese: Përgatitje për Stinën e Nxehtë ; Qëllimi Parandalimi i stresit termik te kafshët. Edukim për hidratimin dhe hijen. Monitorim i temperaturës në ferma. | Korrik | Drejtori |
| 9 | Aplikimi për subvencionim të qumështit 6M-2/2026, sasisë së kg. grurit të dorëzuar, therje të raportuara dhe majmëri të viçave; | Gusht | MBPZHR |
| 10 | Aplikimi për subvencionim të qumështit për litër 0.05€/lit. 6M-1/2026; | Gusht | Komuna |

| | | | |
|----|---|-------------------|----------|
| 11 | Tema trajnuese: Masat profilaktike për parandalimin e sëmundjeve; - Program vaksinimi bazë për sëmundjet e zakonshme blegtorale (bruceloza) - Përdorimi i mjeteve për parandalimin e parazitëve. | Shtator | Drejtori |
| 12 | Tema trajnuese: Ri projektimi i Fermave; - Ndërtimi i stallave me ventilim natyror për të reduktuar stresin termik të kafshët. | Nëntor | Drejtori |
| 13 | Pjesëmarrje në komisione të caktuara me vendime për projekte të ndryshme; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 14 | Menaxhimi i kontratave të ndryshme; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 15 | Përgatitja e raportit vjetor të punës 2026; | Dhjetor | Drejtori |

2. Sevdai Bojku – Zyrtar për Statistika;

| Nr. | Aktivitetet; | Afati kohor; | Përgjegjësi; |
|-----|---|--------------------|---------------------|
| 1 | Faza përgatitore për përgatitjen e data bazës statistikore për vitin 2026; | Janar; | Drejtori |
| 2 | Regjistrimi i fermerëve në programin e eFR. –ës, në kuadër të MBPZHR.-AZHB; | Janar- Dhjetor; | MBPZHR. |
| 3 | - Faza për aplikimin për Pagesat – direke, Subvencione për 6 M – 2 / 2025: - Faza e aplikimin për subvencionim të Qumështit / lit. 0.05 €. /lit. – 6 M - 2/2025; | Janar – shkurt; | MBPZHR./ Komuna; |
| 4 | Hartimi i listës së përgjithshme të aplikuesve dhe përgatitja e listave ndarazi; | Shkurt; | Drejtori |

| | | | |
|----|--|-------------------|-------------------|
| 5 | Faza për aplikimin për Pagesa - direke, Subvencione për gjitha kulturat bujqësore si; Sektori i drithërave; 2. Blegtoria; 3. Bletaria; 4. Shpezëria; 5. Perimekultura; 6. Pemishtet ekzistuese; 7. B.M.A. etj. | Mars; | MBPZHR. |
| 6 | Faza për aplikimin për Pagesa – direke - Subvencionet për gjitha kulturat bujqësore – vazhdimi i aplikimit; | Prill; | MBPZHR. |
| 7 | Përmbledhja në data bazë të gjitha kulturave bujqësore pas aplikimit për pagesa direke – Subvencione, si dhe ndarja e kulturave veç e veç; | Maj; | Drejtori; |
| 8 | Përmbledhja e punëve të kryera në 6 M – 1 /2026; | Qershor; | Drejtori; |
| 9 | Marrje pjesë në programin e Korrje – shirjeve; | Korrik; | Drejtori; |
| 10 | - Faza për aplikimin për Pagesat – direke, Subvencione për 6 M – 1 / 2026: Faza e aplikimin për subvencionim të Qumështit / lit. 0.05 €. /lit. – 6 M -1 / 2026; | Gusht | MBPZHR./ Komuna; |
| 11 | Hartimi i listës së përgjithshme të aplikuesve dhe përgatitja e listave ndarazi; | Shtator; | Drejtori; |
| 12 | Përmbledhja e listave të aplikuesve dhe përfituesve për projektet e realizuara nga drejtorja e bujqësisë për vitin / 2026; | Tetor; | Drejtori; |
| 13 | Hartimi dhe përditësimi i të dhënave bujqësore për sektorët e bujqësisë, 2025-2026; | Nëntor; | Drejtori; |
| 14 | Pjesëmarrje në teren me zyrtarët e drejtorisë, që mbajnë tema trajnuese me fermerë, gjatë tërë vitit kalendarik; | Shkurt – Dhjetor; | Drejtori; |
| 15 | Përcjellja e Informatave të korrje shirjeve, të mbjelljeve etj.; | Dhjetor; | MBPZHR. |
| 16 | Përmbledhja e punëve të kryera për 6 M – 2 /2026; | Dhjetor; | Drejtori; |
| 17 | Ruajtja e dokumentacionit të aplikantëve për pagesa direke nga MBPZHR. dhe projektet e realizuara në DBPZHR.; | Janar- Dhjetor; | Drejtori; MBPZHR. |
| 18 | Pjesëmarrje në komisione në të gjitha projektet e drejtorisë së bujqësisë; | Janar – Dhjetor; | Drejtori; |
| 19 | Mirë mbajtja e Foto galerisë për gjitha punët e kryera; | Janar- Dhjetor; | Drejtori; |

| | | | |
|----|--|---------------|-----------|
| 20 | Shpërndarja e broshurave fermerëve, nga temat e mbajtura nga zyrtarët; | Janar-Dhjetor | Drejtori; |
|----|--|---------------|-----------|

| 1. Kaltrina Kadriji – Zyrtar për Prodhimtari Bimore; | | | |
|---|---|---------------------|---------------------|
| Nr. | Aktivitetet; | Afati kohor; | Përgjegjësi; |
| 1. | Aplikimi për subvencionim të qumështit 6M-2/2025 | Janar | MBPZHR. |
| 2 | Aplikimi për subvencionim të qumështit për litër 0.05€/lit. 6M-2/2025 Komuna | Janar | Drejtori |
| 3. | Tema trajnuese: Përzgjedhja e varieteteve farërave të domates dhe specave në serra; | Janar | Drejtori |
| 4. | Tema trajnuese: Plehërimi dhe ri plehërimi i kulturës së grurit; | Shkurt | Drejtori |
| 5 | Aplikimi i fermerëve për pagesa direkte/subvencione; | Mars | MBPZHR |
| 6. | Tema trajnuese: Përgatitja e ngastrave për mbjelljen e kulturës së misrit; | Mars | Drejtori |
| 7. | Tema trajnuese : Ujitja e perimeve në sera dhe përdorimi i plehrave kristalorë; | Prill | Drejtori |
| 8. | Tema trajnuese: Faza e largimit të thithakëve tek domatja dhe speci, si dhe rëndësia e tyre; | Maj | Drejtori |
| 9. | Hapja zyrtare e fushatës së korrje –shirjeve; | Qershor | Drejtori |
| 10. | Aplikimi për subvencionim të qumështit 6M-2/2026, sasisë së kg. grurit të dorëzuar, therje të raportuara dhe majmëri të viçave; | Gusht | MBPZHR |
| 11. | Aplikimi për subvencionim të qumështit për litër 0.05€/lit. 6M-1/2026 Komuna; | Gusht | Drejtori |
| 12. | Pjesëmarrje në komisione të caktuara me vendime për projekte të ndryshme | Janar/Dhjetor | Drejtori |
| 13. | Menaxhimi i kontratave të ndryshme; | Janar/Dhjetor | Drejtori |

| | | | |
|-----|---|---------|----------|
| 14. | Përgatitja e raportit vjetor te punës 2026; | Dhjetor | Drejtori |
|-----|---|---------|----------|

| 1. Nevzadije Shala – Zyrtare Ligjore; | | | |
|--|---|---------------------|---------------------|
| Nr. | Aktivitetet; | Afati kohor; | Përgjegjësi; |
| 1. | Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi: Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural, ligji për tokat bujqësore, Ligji për blegtori, Ligji për veterinari, Ligji për shërbime këshilluese, Ligji për mbrojtjen e bimëve, Ligji për pesticidet, Ligji për farërat; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 2. | Pajisja me vërtetime për bletarët; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 3. | Pajisja me leje ujore; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 4. | Formulimi i të gjitha akteve administrative të DBPZHR.; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 5. | Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacioneve të rëndësishme; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 6. | Inicimi i ndryshimeve të rregulloreve aplikative me ligjet në fuqi; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 7. | Dhënia e ndihmës juridike stafit të bujqësisë për interpretim dhe zbatim Ligjeve dhe akteve tjera në fuqi; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 8. | Ushtrimi i ankesave të DBPZHR.; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |
| 9. | Procedimi-cedimi i lëndëve për procedurë të mëtutjeshme; | Janar/ Dhjetor | Drejtori |

| 7. Arlind Hyseni – Asistent administrativ; | | | |
|--|--|---------------------|--------------|
| Nr. | Aktivitetet; | Afati kohor; | Përgjegjësi; |
| 1. | Kryen angazhime ditore si asistent administrativ në DBPZHR.; | Janar/ Dhjetor; | Drejtori |
| 2 | Ndihmon palët për kryerje e punëve teknike administrative; | Janar / Dhjetor; | Drejtori |
| 3. | Mban kontakte të rregullta ,me zyrtarët e DBPZHR.; | Janar / Dhjetor; | Drejtori |
| 4. | I ndihmon stafit në kryerjen e punëve teknike; | Janar / Dhjetor; | Drejtori |
| 5 | Angazhohet në gjitha punët me kohë që kërkohet nga mbikëqyrësi; | Janar / Dhjetor; | MBPZHR |
| 6. | Gjatë fazës së subvencioneve nga MBPZHR angazhohet në kryerjen e punëve si dhe u ndihmon fermerëve për kompletim të aplikacioneve për aplikim; | Mars / Prill; | MBPZHR. |

Drejtorja për Buxhet dhe Financa:

| Nr | Objektivat | Masat/Aktivitetet | Afati | Burimet e nevojshme | Pjesëmarrja | Idikatorët e matjes | Reziqet |
|----|------------|-------------------|-------|---------------------|-------------|---------------------|---------|
| . | | | | | | | |

| | | | | | | | |
|----|---|---|--|---|--|--|--|
| 1. | Analiza e punës së Drejtorisë për aktivitetet në vitin 2026 | 1.1 Hartimi i analizës vjetore të punës së Drejtorisë | 15 Janar 2026 | Përcaktimi i objektivave për periudhën në vazhdim | DBF-SEKTORI I BUXHETIT | | Veprimet pa analizë paraprake |
| 2. | Alokimi i Buxhetit për vitin fiscal 2026(Raportimi) Hartimi i Pasqyrave Vjetore Financiare | 2.1Përgatitja fillestare për alokim të Buxhetit 2.3 Raportimi per alokime 2.4 Fletëdeponimet e nëshkrimeve të Zyrtarve Autorizues 2.5 Përgatitja e raportit financiar (TM4) për vitin 2025 | 10-31 janar 2026 Deri më 30 janar | Komunikimi me DMPG Drejtorët/Certifikuesi Zyrtari Kryesor Financiar | DBF DREJTORIT Ë ZKA ZYRTARI CERTIFIKU ES | Saktësia e pasqyrave financiare vjetore dhe afatet kohore të alokimeve | Hartim të paktësia të pasqyrave financiare vjetore |

| | | | | | | | |
|----|--|---|--------------------|---|---|---|---|
| | | 2.6 Përgatitja e Pasqyrave Vjetore Financiare | | Zyrtari Kryesor Financiar/Drejtori | KUVENDI KOMUNAL MFPT/DBF | | |
| 3. | Analiza buxhetore, Shpërndarja, zotimi, shpenzimi, kontrolli, certifikimi, aporvimi i transaksioneve financiare | 3.1 Zotimi sipas planifikimeve buxhetore, 3.2 Shpenzimi lëndëve në SIMFK 3.3 Certifikimi/Aporvimi i lëndëve në SIMFK 3.4 Hapja e avanseve 3.5 Raportimi | Janar-Dhjetor 2026 | Zyrtarja zotuese Zyrtarja e alokimeve Zyrtari Shpenzues Zyrtari certifikues Zyrtari i parasë imët | MFPT DREJTORIT Ë KOMUNAL E ZYRTARËT FINANCIAR | Zotimi i mjeteve para inicimit, pagesa e faturave Brenda afatit ligjor 30ditë | Mos respektim i afateve ligjore sipas rregullores 02/2013 dhe LMFPP |

| | | | | | | | |
|----|---|--|---------------------------------|--|--|---|--|
| 4. | Përgatitja e buxhetit për vitin fiskal 2027 | <p>4.1Pranimi Qarkores së Parë Buxhetore</p> <p>4.2Përgatitja e KAB-it Komunal</p> <p>4.3Pranimi i Qarkorës së Dytë Buxhetore</p> <p>4.4Hartimi I Draft Buxhetit Komunal</p> | <p>15 Maj</p> <p>30 Shtator</p> | <p>Zyrtari Kryesor Administrativ</p> <p>Kuvendi Komunal</p> <p>Zyrtari Kryesor Financiar</p> <p>Drejtorët e drejtorive Komunale</p> <p>Qytetarët</p> | <p>MFPT</p> <p>ZKA</p> <p>KK</p> <p>DREJTORIT</p> <p>DBF</p> <p>QYTETARË T</p> | <p>Realizimi i afateve ligjore sipas planit të hartimit të buxhetit, dhe palnifikimi i buxhetit që përmbushë objektivat e Komunës</p> | <p>Planifikim jo adekuat i të gjitha prioriteteve Komunale, sidomos në projektet zhvillimore</p> |
| 5. | Implementimi dhe realizimi i Buxhetit Komunal 2026 | <p>5.1 Zotimet sipas planit kontabël dhe afateve ligjore</p> | | <p>Zyrtari Kryesor Financiar</p> <p>Zyrtarja zotuese</p> | <p>MFPT</p> <p>ZKA</p> <p>ZKF</p> | <p>Realizimi i buxhetit sipas planifikimev</p> | <p>Keqklasifikimi shpenzimeve dhe mos</p> |

| | | | | | | | |
|--|--|---|--|---|--|---|--|
| | | <p>5.2 Ritja e nivelit të Kontrollit të Brendëshëm të Financave Publike</p> <p>5.3 Analiza dhe hartimi i raporteve periodike (tre mujore) sipas periudhave fiskale</p> <p>5.4 Raportet sipas nevojave të Drejtorive</p> <p>5.5 Realizimi i Buxhetit sipas planit dhe evitimi i suficitit buxhetor</p> | <p>10 Janar 31 Dhjetor</p> <p>Periodike sipas periudhave fiskale dhe kerkesave të drejtorive</p> | <p>Zyrtarja e alokimeve</p> <p>Zyrtari Shpenzues</p> <p>Zyrtari certifikues</p> <p>ZKA</p> <p>Zyrtari Kryesor Financiar</p> <p>Zyrtarët financiar</p> | <p>DREJTORË T</p> <p>ZYRTARËT FINANCIA R</p> <p>ZKA</p> <p>ZKF</p> <p>DREJTORË T</p> | <p>e buxhetore, dhe shmangjen e suficitit buxhetor.</p> <p>Transparenca në menaxhimin e shpenzimeve</p> | <p>respektimi planit kontabël për të gjitha kategoritë ekonomike</p> |
|--|--|---|--|---|--|---|--|

| | | | | | | | |
|----|---------------------------------------|---|------------------|---------------------|---|---|---|
| | | | | | ZYRTARËT FINANCIA R | | |
| 6. | Përmbyllja e vitit fiskal 2026 | 6.1 Analiza buxhetore, zotimet, urdhërblertjet 6.2 Mbyllja e avanseve për udhëtime zyrtare 6.3 Mbyllja e avanseve për petty cash 6.4 Raportimi | Janar Dhjetor | Spektori I Buxhetit | ZKA ZKF ZYRTARËT FINANCIA R | Përmbushja e afateve ligjore për përfundimin e vitit fiskal | Rreziqet në trajtimin e zotim/obligimeve, dhe normën e realizimit të buxhetit |

| | | | | | | | |
|----|---|--|-----------------------|---|--|--|---|
| 7. | Hartimi I planit të veprimit për ZKTP | <p>1.1 Duke u bazuar në raportin vjetorë të vitit paraprak dhe kërkesave të ligjit mbi TP.</p> <p>1.2. Caktimi I zyrtarëve të terrenit</p> <p>1.3. caktimi I zyrtarëve në zyrë</p> | 15 Janar dhjetor 2026 | <p>Komunikimi me DTP</p> <p>Neni 15. Pasuesi 2. Ligji nr.06/L-005</p> | Menagjeri I ZKTP dhe Zyrtari I lartë në ZKTP | <p>Raporti vjetorë dhe kërkesat të cilat burojnë nga ligji për TP,</p> <p>Rianketimi I 20% e objekteve të regjistruara në sistem</p> <p>(3100 rianketime)</p> | Mos hartimi I planit të veprimit paraqet rrezik në realizimin e objektivave |
| 8. | Regjistrimi dhe rianketimi I objekteve dhe parcelave | Duke u bazuar në numrin e lejeve ndërtimore dhe numrin e objekteve ekzistuese : | | Vetëdeklarimi dhe inspektimi | Zyrtarët anketues | Krahasimi në mesë të | |

| | | | | | | | |
|----|---|---|--------------------|---|----------------------------------|--|---|
| | | <p>2.1. Caktimi i zyrtareve në ekipe për regjistrim,</p> <p>2.2.Caktimi i ekipës për rianketime të objekteve ekzistuese</p> | Janar-dhjetor | <p>në sistem dhe teren</p> <p>3100 rianketime të objekteve</p> <p>200 rianketime të parcelave</p> | | objekteve për rianketim dhe objekteve të rianketuara | <p>Mos rianketimi I objekteve paraqet rrezik për llogarotje të saktë të TP.</p> <p>Ndikon negativisht në performansën e komunës në raportet e Auditorit</p> |
| 9. | Rexhistrimi dhe arhivimi I lëndëve | Të gjitha objektet e regjistruar dhe rianketuara duhet të | Janar-Dhjetor 2026 | -Të dhënat e dorëzuzra nga zyrtarë anketues | 1.Zyrtarja administrativ e e TP, | Shqyrtimi, verifikimi në sistem dhe | Mosdorzimi I lëndëve nga |

| | | | | | | | |
|----|--|--|-----------------|---|-------------------------------|--------------------|------------------------|
| | | regjistrohen dhe arhivohen landet: 3.1.Caktimii një zyrtareje për evidence e objekteve te reja 3.2. caktimi i zyrtares per regjistrimin e objekteve te rianketuara | | për objektet e rianketuara -Të dhënat e dorëzuar për objektet e regjistruara | 2.Zyrtarja e vlerësimit të TP | arkivimi I landëve | zyrtaret anketues |
| 10 | Dhënia e çertifikatave të pagesës (vërtetimeve) | Shërbimi i qytetareve sipas kërkesës së tyre | Janar - dhjetor | Sipas kërkesave të palëve | Zyrtarja e vlerësimit të TP | Veprim I momentit | Nuk llogariten rreziqe |

| | | | | | | | |
|----|--|--|-----------------|-----------------------------------|------------------|---|---|
| 11 | Vetë kontrolla | Hartimi i raporteve javore, mujore, periodike dhe vjetore | Janar - dhjetor | Raportet individuale te zyrtareve | Zyrtaret ne ZKTP | Krahasimi në mese të planit dhe veprimeve | Mos hartimi I raporteve mundë të shkaktojë devijime në planin e realizimit |
| 12 | Plani I realizimit të të hyrave të TP për vitin fiskal 2026 | <ol style="list-style-type: none"> 1. Të hyrat nga tatimi në objekte 2. Të hyrat nga tatimi në parcela | Janar-dhjetor | 481,693.00 120,667.00 | | | Paqartësia në kompetencat dhe mungesa e një manuali të qartë për realizimin e borgjeve të painkasuara |

| | | | | | | | |
|----|---|--|--------------------------|---|---|--|---|
| 13 | Identifikimi i të gjitha subjekteve afariste që veprojnë në territorin e Komunës së Kamenicës (të cilat në bazë të rregullores ngarkohen me Taksë Komunale) dhe nxjerja e vendimeve për ngarkesë me Taksë Komunale për të njëjtat; | 1.1. Mbledhja e shënimeve për subjektet afariste të cilat veprojnë (janë aktive) përkatësisht ushtrojnë veprimtari me qëllim fitimi, për ngarkimin me ngarkesa komunale për vitin 2026(Procesverbal e) 1.2. Analiza e vërtetësisë së shënimeve të mbledhura për | 01 Janar deri më 30Prill | Zyrtarët e Sektorit dhe veturë në dispozicion për operim në teren | 1. Zyrtari i Lartë për Financa dhe Buxhet; 2.Zyrtari për Arkëtim; 3.Zyrtarja për Buxhet dhe Financa; 4. Përgjegjësi i punëve juridike; 5.Inspektori i Tregut pranë DSHPAI | | Mos harmonizimi me Zyrën për Regjistrim të Bizneseve dhe Inspektorin e Tregut |
|----|---|--|--------------------------|---|---|--|---|

| | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | <p>subjektet e regjistruara në ARBK (MTI) dhe dhënja e pëlqimit të njejtave nga DSHPAI, konsultimi i regjistrave për nxjerrjen e vendimeve;</p> <p>1.3.Nxjerrja Vendimeve për Ngarkesë me Taksë Komunale;</p> | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | <p>1.4.Distribuimi(dor ë zimi) gradual i vendimeve të nxjerra për Ngarkesa-Taksa Komunale;</p> <p>1.5 Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave mbi vendosjen e ngarkesave;</p> | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | | | |
|----|---|---|----------------------|---|---|----------------------|--|
| 14 | Zvogëlimi i borxhit të akumuluar | <p>2.1. Identifikimi me qëllim të përgatitjes së “Njoftimeve mbi Borxhet” i bizneseve dhe qiramarrësve me obligime të vitit aktual dhe viteve paraprake me qëllim arkëtimi i borxheve nga viti aktual dhe borxhet e akumulara nga vitet paraprake;</p> <p>2.2. Lidhja e Kontratave për Riprogramim të</p> | Korrik-Dhjetor, 2026 | Shënimet apo tabelat e ngarkesave me taksë komunale dhe Qira komunale | <ol style="list-style-type: none"> 1. Zyrtari i Lartë për Financa dhe Buxhet; 2. Zyrtari për Arkëtim; 3. Zyrtarja për Buxhet dhe Financa; 4. Përgjegjësi i punëve juridike; | Saktësia e shënimeve | Ndrimi i adresave të pronarëve të bizneseve passive; Zhvillim i politikave për mundësinë e inkasimit të borxheve për taksë komunale |
|----|---|---|----------------------|---|---|----------------------|--|

| | | | | | | | |
|----|--|---|---|---|---|---|--|
| | | borxheve të grumbulluara; | | | | | |
| 15 | Realizimi i planit të arkëtimit në sektorin e Financave | <p>3.1. Pasqyrimi i pagesave nga Taksat Komunale;</p> <p>3.2. Monitorimi i pagesave nga Qiraja;</p> <p>3.3. Lidhja e Kontratave për Riprogramim të</p> | <p>Janar-Dhjetor, 2026</p> <p>Taksa 66,000.00</p> <p>Qiraja 60,000.00</p> | Shënimet apo tabelat e ngarkesave me taksë komunale dhe Qiraja komunale | <p>1.Zyrtari i Lartë për Financa dhe Buxhet;</p> <p>2.Zyrtari për Arkëtim;</p> <p>3.Zyrtarja për Buxhet dhe Financa;</p> <p>4. Përgjegjësi i punëve juridike;</p> | Vlera e realizuar në proporcion me planifikimin | Mosgatishmëria e pronarëve të bizneseve për të hyrë në detyrime kontraktuale |

| | | | | | | |
|----|--|---|---------------------------|--|---|--|
| | | <p>borxheve të grumbulluara;</p> <p>3.4.Bashkëpunimi me Drejtorin për vlerësimin e proceseve dhe rekomandime për ndryshimin dhe përmirësimin me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë në punë</p> | | | | |
| 16 | <p>Nxjerrja e Vendimeve me 10% zbritje nga Taksa Komunale</p> | <p>4.1. Informimi I bizneseve për mundësinë e përfitimit të zbritjes 10% ;</p> | <p>Janar-Korrik, 2026</p> | | <p>1. Zyrtari i Lartë për Financa dhe Buxhet;</p> | |

| | | | | | | | |
|----|---|---|--|---------------------|--|---|---|
| | | <p>4.2. Identifikimi I bizneseve që plotësojnë kriteret për përfitim të zbritjes</p> <p>4.3.Nxjerrja e vendimeve;</p> <p>4.4.Pasqyrimi i zbritjes në tabelë.</p> | | | <p>2.Zyrtari për Arkëtim;</p> <p>3.Zyrtarja për Buxhet dhe Financa;</p> <p>4. Përgjegjësi i punëve juridike;</p> | | |
| 17 | Gjatë ushtrimit të punëve dhe detyrave të garantohet zbatimi i ligjeve | 5.1. Konsulltimi i vazhdueshëm i Rregullores Sh.01 Nr.01-5300 të datës 16.02.2023 | | Janar-Dhjetor, 2026 | 1.Zyrtari i Lartë për Financa dhe Buxhet; | Realizimi i punëve dhe aktiviteteve brenda afateve të | Mungesa e informatave të pronarëve të bizneseve mbi |

| | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|---|---|
| | <p>dhe akteve tjera nënligjore.</p> | <p>5.2.Mbikëqyrja dhe koordinimi i punëve administrative të njësisë përkatëse</p> <p>5.3.Udhëzime, këshillime në kuadër të drejtorisë, analizime dhe zgjidhja e problemeve, kryerja e punëve në përputhje me procedurat.</p> | | | <p>2.Zyrtari për Arkëtim;</p> <p>3.Zyrtarja për Buxhet dhe Financa;</p> <p>4. Përgjegjësi i punëve juridike;</p> | <p>përcaktuara me Rregullore, ligje dhe akte nënligjore</p> | <p>rregulloren, ligjet dhe aktet nënligjore</p> |
|--|--|--|--|--|--|---|---|

| | | | | | | | |
|--|--|---|--|--|--|--|--|
| | | <p>5.4 Mbështetja dhe ofrimi i këshillave për drejtorin dhe udhëheqësin më të lartë administrativë</p> | | | | | |
|--|--|---|--|--|--|--|--|

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme:

Misioni i drejtorisë :

Drejtoria e Administratës së përgjithshme kryen punë dhe detyra të parapara me legjislacionin në fuqi dhe në bazë të Udhëzimeve Administrative, përmirësimi i strukturës legjislative dhe efikasiteti praktik në implementimin e tyre, lehtësimeve të procedurave administrative, komunikim korrekt me qytetarët qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt qoftë sipas formave të sistemit elektronik, trajtimi me kohë të kërkesave të qytetarëve. Një administratë funksionale dhe transparente është gjithashtu një kontribuues i rëndësishëm për legjitimitet të shtetit dhe besueshmërisë. Andaj, për të promovuar performancë më të avancuar të shërbimeve cilësore për qytetarët e Komunës së Kamenicës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, prezanton planin dhe objektivat për vitin 2026.

Qëllimi i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është i orientuar si vijon:

- Ofrimi i shërbimeve sa më cilësore për qytetarët;

- Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në punë;
- Forcimi i kontrollit dhe raportimit në punë;
- Sigurimi i transparencës maksimale;
- Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në raport me shërbimet e Drejtorisë;
- Lehtësimi dhe ruajtja e dokumentacionit në Administratën Komunale;
- Lehtësimi i qasjes së qytetarëve në shërbime.

Buxheti i planifikuar për vitin 2026


| | |
|-----------------------------|-----------------|
| Paga dhe medijtje | 313 727€ |
| Mallra dhe shpenzime | 180 000€ |
| Investimet kapitale | 155 000€ |

- **Planin Vjetor të Punës për vitin 2026**

Drejtorja e Administratës së Përgjithshme organizohet përmes Sektorëve dhe Zyrave të ndryshme :

- Sektori i Gjendjes Civile;
- Qendra për Shërbime me Qytetar / QSHQ- ja ;
- Zyra për punë të kuvendit komunal;

- Zyrën për teknologji informative –IT;
- Zyrën për furnizime;
- Zyrën për përkthime;
- Zyra për Logjistike;
- Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore;
- Sektorin për Mirëmbajtjen, Pastrim dhe Sigurim.



PLANI VJETOR I PUNËS – Sektori i Gjendjes Civile 2026

1. Qëllimi i Planit të Punës

Të sigurohet funksionim i qëndrueshëm, profesional dhe efikas i Sektorit të Gjendjes Civile përmes raportimit të rregullt, ngritjes së cilësisë së shërbimeve dhe bashkëpunimit institucional.

2. Objektivat Kryesore të Vitit 2026

1. Standardizimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.
2. Raportim i rregullt dhe i saktë në të gjitha instancat.
3. Forcimi i kapaciteteve të stafit dhe menaxhimi i performancës.
4. Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për gjendjen civile.
5. Përgatitja profesionale e sektorit për sezonin e diasporës.
6. Rritja e transparencës dhe komunikimit me qytetarët.

1. Përmirësimi i regjistrimit të ngjarjeve të gjendjes civile

- Sigurimi i regjistrimit të saktë, të plotë dhe në kohë të lindjeve, martesave dhe vdekjeve brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
- Ofrimi i informatave të sakta dhe të qarta për qytetarët lidhur me procedurat e regjistrimit të ngjarjeve të gjendjes civile.
- Rritja e kënaqësisë së qytetarëve përmes përmirësimit të kohës së shërbimit dhe cilësisë së shërbimeve administrative.

2. Efikasiteti në lëshimin e dokumenteve të Gjendjes Civile

- Lëshimi i dokumenteve të Gjendjes Civile dhe akteve administrative brenda afateve optimale.
- Zbatimi i plotë i Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 01/2022 për dokumentet e Gjendjes Civile me QR Code, duke garantuar vërtetimin e autenticitetit.
- Zbatimi konsekuent i legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës në procesin e lëshimit të dokumenteve.

3. Rritja e performancës dhe menaxhimit të stafit

- Monitorimi i vazhdueshëm i punës dhe aktiviteteve të zyrtarëve të Gjendjes Civile.
- Përmirësimi i efikasitetit në punë dhe arritja e rezultateve më të mira në shërbime.
- Përmirësimi i kushteve të punës përmes furnizimit të zyrave me pajisje dhe mjete të nevojshme teknike.

4. Fuqizimi i bashkëpunimit institucional

- Forcimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrinë e Administrimit Publik (MAP).
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Departamentin për Regjistrimin e Gjendjes Civile dhe Agjencinë e Regjistrimit Civil (DRGJC–ARC) në kuadër të MPB-së.
- Koordinimi me sektorët e Teknologjisë Informative për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve digjitale që përcjellin punën e sektorit.

5. Përmirësimi i raportimit dhe statistikave të Gjendjes Civile

- Hartimi dhe dorëzimi i rregullt i raporteve javore, mujore dhe vjetore për aktivitetet e sektorit.
- Përgatitja e raporteve statistikore tabelore për lindjet, martesat dhe vdekjet.
- Dërgimi në kohë i të dhënave statistikore tek Enti i Statistikës së Republikës së Kosovës.

6. Zbatimi i legjislacionit dhe udhëzimeve të reja

- Zbatimi i plotë dhe në kohë i ligjeve dhe udhëzimeve administrative të reja në sektorin e Gjendjes Civile.
- Informimi dhe njoftimi i rregullt i zyrtarëve të Gjendjes Civile për ndryshimet ligjore dhe procedurale.

7. Rritja e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve për qytetarët

- Sigurimi i shërbimeve të shpejta, të sakta dhe transparente për qytetarët.

- Përmirësimi i qasjes së qytetarëve në shërbimet e Gjendjes Civile përmes informimit të vazhdueshëm dhe përdorimit të teknologjisë.

- **QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË - OBJEKTIVAT**

-

- **1.Zyrtarët janë përgjegjës**

1.1. Në pjesën më të madhe të kohës, Q.SH.Q - ja pranon dokumentacion dhe mban përgjegjësi për të mirë dhe kur diçka shkon keq me kërkesën. Qendra mund të mos ketë përgjegjësi ligjore, por për qytetaret është përgjegjëse. Prandaj është e rëndësishme të identifikojmë se si qytetari dëshiron të përdorë kërkesën. Nëse kërkesa është shkruar gabimisht përpikuni të korrigjoni me qytetarin dhe të udhëzoni atë si ta shkruaj ashtu siç duhet. Në të kundërt, qendra mund të mos pranoj kërkesën , nëse nuk beson se ai do të përdoret si duhet nga qytetari . Megjithëse, kjo pjesë mbulohet nëpërmjet dokumenteve tjera . Në fund të fundit, ju zyrtaret jeni përgjegjës si e trajtoni kërkesën .

Objektivat vjetore të Qendrës për Shërbime me Qytetar

1. Rritja e cilësisë së shërbimeve administrative për qytetarët

1.1.Sigurimi i ofrimit efikas të shërbimeve të arkivës, gjendjes civile, dhe të gjitha shërbimeve të tjera komunale gjatë gjithë vitit.

1.2.Standardizimi i procedurave të punës për të gjitha llojet e shërbimeve brenda qendrës.

2. Përmirësimi i informimit të qytetarëve

2.1 Shpërndarja vjetore e broshurave, fletëpalosjeve dhe materialeve informuese për qytetarët dhe grupet e interesit.

2.2 Rritja e transparencës për procedurat administrative dhe dokumentacionin e nevojshëm.

3. Ofrimi i këshillimit dhe asistencës teknike për qytetarët

3.1 Sigurimi i ndihmës administrative gjatë plotësimit të kërkesave, aplikimeve dhe formularëve.

3.2 Trajnimi i stafit për ofrim të këshillimit profesional dhe të unifikuar për qytetarët.

4. Përmirësimi i procesit të pranimit dhe regjistrimit të kërkesave

4.1 Mirëfunksionimi i sistemit të pranimit, regjistrimit dhe shpërndarjes së kërkesave gjatë gjithë vitit në drejtoritë përkatëse.

4.2 Rritja e efikasitetit në regjistrimin e kërkesave përmes sistemit të intranetit.

5. Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të dokumenteve dhe statistikave

5.1 Mbajtja dhe azhurnimi i dosjeve për të gjitha kërkesat e pranuar.

5.2 Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore me statistika të sakta mbi kërkesat e qytetarëve.

6. Përmirësimi i sistemit të protokollimit

6.1 Shtypja dhe mirëmbajtja e librit të protokollit nga sistemi i intranetit.6.2

6.2 Protokollimi i të gjitha akteve të organeve komunale me numër unik protokollit përmes softuerit të administrimit të dokumenteve.

7. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe vlerësimi i kënaqshmërisë

7.1 Mbledhja dhe analiza e opinioneve të qytetarëve për shërbimet e qendrës, të paktën një herë në tremujor.

7.2 Hartimi i raporteve të kënaqshmërisë së qytetarëve dhe propozimet për përmirësim.

8. Përmirësimi i procesit të qarkullimit të lëndëve përmes intranetit

8.1 Leximi, shqyrtimi dhe përcjellja korrekte e të gjitha lëndëve të paraqitura përmes intranetit.

8.2 Dërgimi i lëndëve tek drejtoritë përkatëse.

9. Sigurimi i qasjes unike dhe transparente për qytetarët dhe grupet e interesit

9.1 Informimi i rregullt i qytetarëve mbi ecurinë e lëndëve të tyre të proceduara përmes intranetit.

9.2 Lehtësimi i komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve komunale përmes një pike të vetme kontakti.

ZYRA PËR PUNË TË KUVENDIT

Në këtë vite drejtorja e Administratës ka si objektivë zhvendosjen e sallës së kuvendit në Shtëpinë e Kulturës si dhe mobilimi dhe digjitalizimi i Kuvendit.

